



STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR ZVOGËLIMIN E NUMRIT TË RASTEVE TË PAZGJIDHURA GJYQËSORE LIDHUR ME PRONËN

16 mars 2007, Prishtinë/Priština

Hyrje

Institucionet e Kosovës po orjentohehen në një transicion drejt një sistemi gjyqësor i cili garanton një mbrojtje të plotë të drejtave pronësore në përputhje me sundimin e ligjit dhe standardet Evropiane. Gjykatat e Kosovës me të vërtetë po zhvillohen drejt një sistemi funksional, modern të gjykatave në të cilin vendimet në rastet pronësore dhe në rastet e tjera të ngjashme nxjerren në mënyrë konsekuente dhe me kohë, si dhe në të cilin ekzekutimi i vendimeve bëhet me kohë, në mënyrë efektive dhe zbaton mbrojtje të duhur të procesit. Në mënyrë për të qenë i suksesshëm, kompletimi i këtij procesi transitor kërkon një qasje strategjike në të cilën të gjitha palët e angazhuara do të koordinojnë përpjekjet e institucioneve ndërkombëtare dhe autoriteteve lokale drejt realizimit këtij qëllimi strategjik - zvogëlimin e rasteve të pazgjithura pronësore në Kosovë.

Kjo strategji dhe plan i veprimit për zvogëlimin e numrit të rasteve të pazgjithura gjyqësore përqendrohet në:

- Identifikimin e rasteve ekzistuese të pazgjithura pronësore;
- Identifikimin e zgjidhjeve të mundshme për zvogëlimin e numrit të rasteve ekzistuese;
- Veprimet në parandalimin e shfaqjes së tyre në të ardhmen.

Ajo ka për qëllim që t'u ofrojë institucioneve kompetente dhe gjykatave një mjet operacional në këtë fushë të veçantë dhe së këndejmi të ju ndihmojë për të siguruar që individëve dhe subjekteve t'u mundësohet që të gëzojnë të drejtat e tyre pronësore dhe për tu garantuar atyre një qëndrueshmëri dhe siguri të tregut të patundshmërive në Kosovë.

Historiku

Mbrojtja gjyqësore e së drejtës pronësore po ndikohet nga një vëllim më rritje të rasteve në gjykata. Aktualisht, ekzistojnë më shumë se 10,000 raste që presin për t'u zgjidhur nga gjykatat e Kosovës. Disa nga këto raste kanë qenë në pritje për një kohë më të gjatë se korniza e pranuar kohore ndërmjet inicimit të procesit gjyqësor dhe përcaktimit përfundimtar dhe/ose ekzekutimit, duke rezultuar kështu me raste gjyqësore të pazgjithura. Kjo është një çështje shqetësuese pasi që një zgjatje e paarsyeshme e procedurave gjyqësore shpie në shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë (Neni 6, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut).

Prandaj, është e rëndësishme që të përcaktohen përmasat dhe të identifikohen shkaqet kryesore të vonesave, pozita në kuadër proceseve të menaxhimit të rrjedhës së rasteve



STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR ZVOGËLIMIN E NUMRIT TË RASTEVE TË PAZGJIDHURA GJYQËSORE LIDHUR ME PRONËN

dhe përqëndrimit gjeografik (p.sh. Gjykatat Komunale në Prizren dhe Prishtinë/Priština aktualisht kanë 50 përqind të rasteve të lartëpërmendura).¹ Ndonëse ndryshimet e rregulloreve dhe ato ligjore mund të jenë të nevojshme, çështjet e menaxhimit siç janë rialokimi (ose rritja e numrit) të personelit dhe resurseve të gjykatave mund të kenë një ndikim po aq të rëndësishëm në përmirësimin e menaxhimit të rasteve.

Përveç rasteve të përmendura më lartë, ekziston një numër i konsiderueshëm i rasteve prej më shumë se 18,000 raste që aktualisht nuk janë duke u procesuar nga gjykatat në bazë të udhëzimeve nga bashkësia ndërkombëtare. Shumica dërmuese e këtyre rasteve janë kërkesa për kompensim kundër UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe individëve që janë depozituar nga pjesëtarët e komunitetit serb. Veç kësaj, ekzistojnë më shumë se 2,900 raste të një natyre të ngjashme të cilat janë deponuar nga individ shqiptar të Kosovës të cilat gjithashtu nuk po procesohen. Këto grupe të veçanta të rasteve kanë nevojë për një zgjidhje adekuate e cila duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Kjo strategji dhe plan i veprimit ka për qëllim që të:

- a) identifikojë natyrën dhe shtrirjen e rasteve të pazgjidhura pronësore në gjykatat e Kosovës,
- b) konsiderojë reformën ligjore dhe ofrimin e asistencës për të përmirësuar procesimin nga gjykatat duke respektuar plotësisht pavarësinë e gjyqësisë,
- c) rritjen e efikasitetit të gjykatave të rregullta në çështjet pronësore,
- d) kontribuojë në drejtim të gjetjes së metodës për zgjidhjen e rasteve ku kërkohet kompensimi që ka të bëjë me konfliktin të pezulluara në gusht 2004 dhe
- e) parandalimin e paraqitjes së kontesteve të reja pronësore përmes ndërmjetësimit, ngritjes së vetëdijes dhe aktiviteteve policore.²

Strategjia dhe Plan i Veprimit do të shërbejnë si mjet udhëzues për institucionet e Kosovës dhe për bashkësinë ndërkombëtare për t'i përqëndruar përpjekjet në zbatimin e kërkesave të Standardeve për Kosovën dhe të Planit të Zbatimit të Partneritetit Evropian (PZPE). Mbikëqyrja e zbatimit të tij duhet të merret përsipër nga strukturat që merren me procesin të Standardeve dhe të Partneritetit Evropian dhe/ose pasardhësit e tyre.

¹Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 'Raporti i të dhënave statistikore lidhur me Standardin 6, Veprimi 3.2', janar 2007.

² Strategjia dhe Plan i Veprimit për Zvogëlimin e Numrit të Rasteve të Pazgjidhura Gjyqësore lidhur me Pronën është rezultat i përpjekjeve të koordinuara të palëve relevante të angazhuara, siç janë Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)², Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MAPH), Agjencia Kosovare e Pronës (AKP); Departamenti i Drejtësisë (DD) i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Ekipi Planifikues i Bashkimit Evropian (EPBE), Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)/Qendra Nacionale për Gjykatat Shtetërore (NCSC) dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë.



STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR ZVOGËLIMIN E NUMRIT TË RASTEVE TË PAZGJIDHURA GJYQËSORE LIDHUR ME PRONËN

	Veprimet	Afatet kohore	Aktorët e përfshirë	Pikësynimet afatmesme (6 muaj-1 vit).	Pikësynimet afatgjata (2-3 vite).
Qëllimi 1	Identifikimi i natyrës dhe përmasave të problemeve që kanë të bëjnë me zgjidhjen e rasteve lidhur me pronën.				
	1.1. Identifikimi i llojeve dhe statusit aktual të rasteve të pasurisë së patundshme që janë në pritje para gjykatave, përfshirë identifikimin e rasteve që bëjnë në kuadër të standardeve të identifikuar kohore për menaxhimin e rrjedhës së rasteve.	janar – gusht 2007.	KGJK (udhëheq), USAID/NCSC, OSBE, DD i UNMIK-ut, BE.	Të përfundojë identifikimi.	Të bëhet rivlerësimi nëse është e përshtatshme.
	1.2. Të bëhet vlerësimi i arsyeve për vonesat, siç janë dërgesa e dokumenteve gjyqësore dhe bashkëpunimi institucional me Republikën e Serbisë, si dhe identifikimi mundësive për përmirësimin e menaxhimit të rasteve që kanë të bëjnë me pronën.	(Në vazhdim e sipër).	KGJK (udhëheq), USAID/NCSC, OSBE, BE, UNMIK DD	Të hartohet vlerësimi.	Të zbatohen rekomandimet.
Qëllimi	Sigurimi i reformave ligjore dhe i asistencës për përmirësimin e procesimit të				



STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR ZVOGËLIMIN E NUMRIT TË RASTEVE TË PAZGJIDHURA GJYQËSORE LIDHUR ME PRONËN

	Veprimet	Afatet kohore	Aktorët e përfshirë	Pikësynimet afatmesme (6 muaj-1 vit).	Pikësynimet afatgjata (2-3 vite).
2	rasteve lidhur me pronën.				
	2.1. Analizimi ligjeve relevante të procedurës civile në mënyrë që të hartohen amandamentet që nevojiten për të përmirësuar menaxhimin e rasteve dhe efikasitetin e gjykatave.	qershor 2007 – qershor 2008	BE (udhëheq), DD, KGJK, USAID/NCSC.	Të hartohen analizat.	Të propozohen dhe të miratohen amandamentet.
	2.2. Hartimi dhe miratimi i amandamenteve të nevojshme në legjislacionin relevant.	qershor 2007 – qershor 2008.	BE, UNMIK, ZKM, Kuvendi i Kosovës.	Të propozohen amandamentet.	Të propozohen dhe të miratohen amandamentet.
Qëllimi 3	Rritja e efikasitetit të gjykatave të rregullta në rastet pronësore.				
	3.1. Monitorimi i trendeve statistikore në rastet që kanë të bëjnë me pronën.	(Në vazhdim e sipër).	KGJK (udhëheq), USAID/NCSC.	Statsistikat po përgatiten çdo tre muaj.	Të vazhdohet me përgatitjen e statistikave sipas nevojës.
	3.2. Identifikimi i nevojave të gjykatave për të përmirësuar menaxhimin e rasteve në bazë të analizave të praktikave aktuale dhe rekomandimet për praktikën më të mirë.		KGJK (udhëheq), USAID/NCSC, BE, AER, DD (Sektori i Revizionit).	Të hartohen analizat.	Të zbatohen rekomandimet.



STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR ZVOGËLIMIN E NUMRIT TË RASTEVE TË PAZGJIDHURA GJYQËSORE LIDHUR ME PRONËN

	Veprimet	Afatet kohore	Aktorët e përfshirë	Pikësnyimet afatmesme (6 muaj-1 vit).	Pikësnyimet afatgjata (2-3 vite).
	3.3. Gjykatësve dhe personelit të gjykatave t'u ofrohet trajnimi mbi kodin aktual të procedurës civile dhe mbi praktikat e menaxhimit të rasteve.	Fillimi i janarit 2007 (Në vazhdim e sipër).	Instituti Gjyqësor i Kosovës (udhëheq), KGJK, USAID/NCSC.	Të zhvillohet programi i trajnimit.	Të zhvillohet trajnimi i duhur.
	3.4. Zhvillimi i udhëzuesve specifik për gjykatat në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i rrjedhës së rasteve për të gjitha rastet civile. ³	(Në vazhdim e sipër).	KGJK (udhëheq), USAID/NCSC.	Të hartohen udhëzuesit.	Të zbatohen udhëzuesit.
Qëllimi 4	Zgjidhja e rasteve që lidhen me konfliktin të pezulluara në gusht 2004 dhe rastet e ngjashme.				
	4.1. Identifikimi i gjendjes aktuale dhe numrit të rasteve që kanë të bëjnë me pronën të paraqitura nga serbët e Kosovës kundër KFOR-it, UNMIK-ut, komunave dhe individëve të	(Në vazhdim e sipër).	KGJK (udhëheq), USAID/NCSC, BE, AKP, UNMIK.	Të përfundojë identifikimi.	Të bëhet rivlerësimi nëse ka nevojë.

³ Këta udhëzues do t'i referohen vetëm menaxhimit të rasteve dhe administratës gjyqësore në kuadër të kompetencave të mandatuara ligjore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe nuk do të ndërhyjë në pavarësinë e gjyqësisë.



STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR ZVOGËLIMIN E NUMRIT TË RASTEVE TË PAZGJIDHURA GJYQËSORE LIDHUR ME PRONËN

	Veprimet	Afatet kohore	Aktorët e përfshirë	Pikësynimet afatmesme (6 muaj-1 vit).	Pikësynimet afatgjata (2-3 vite).
	pezulluara nga DD-ja në gusht 2004 si dhe rastet e ngjashme.				
	4.2. Zhvillimi i propozimit për të dhënë gjykimet në mënyrë ekspeditive për rastet që kanë të bëjnë me pronën të paraqitura nga serbët e Kosovës kundër KFOR-it, UNMIK-ut, komunave dhe individëve, të pezulluara në vitin 2004 (dhe rasteve të ngjashme), përfshirë asistencën për gjykatat dhe gjykatësit dhe eliminimin e pengesave ligjore.	mars 2007-qershor 2007.	BE (udhëheq), AKP, OSBE, UNMIK.	Të hartohet strategjia.	Të zgjidhen rastet.
Qëllimi 5	Parandalimi i rasteve të reja pronësore.				
	5.1. Sigurimi i veprimit efektiv nga policia dhe prokurorët në rastet e uzurpimit joligjor të pasurisë të patundshme.	(Në vazhdim e sipër).	Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës (udhëheq), policia.	Të zbatohen udhëzimet.	Vlerësimi cilësor.



STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR ZVOGËLIMIN E NUMRIT TË RASTEVE TË PAZGJIDHURA GJYQËSORE LIDHUR ME PRONËN

	Veprimet	Afatet kohore	Aktorët e përfshirë	Pikësnyimet afatmesme (6 muaj-1 vit).	Pikësnyimet afatgjata (2-3 vite).
	5.2. Vlerësimi i mekanizmave ekzistues të ndërmjetësimit dhe i nevojave, në mënyrë që të parandalohet arritja e kontesteve në sistemin gjyqësor.	(Në vazhdim e sipër).	KGJK (udhëheq), USAID/NCSC, MD.	Të hartohet vlerësimi.	Të përfundohet vlerësimi, të zbatohen rekomandimet.
	5.3. Zhvillimi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes për të promovuar mjetet juridike dhe për të frenuar në të ardhmen uzurpatorët ilegal.	mars 2007 – dhjetor 2008	MAPH (udhëheq), OSBE.	Të hartohet propozimi.	Aktivitetet të zhvillohen rregullisht.